



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES

Nr. 2187 / Prot.

Tiranë, më 28/12 .2021

Lënda: Mbi dhënien e miratimit paraprak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (kontrollit) në kapitalin e subjektit financiar jobankë “TRANZIT” sh.p.k.

TRANZIT SH.P.K.
Rruga e Kavajës, Ndërtesa 59, Kati 3, Kodi Postar 1001, Tiranë

Zj. Kristina Naumi
Administratore

E nderuar zj. Administratore,

Banka e Shqipërisë mori në shqyrtim kërkesat e paraqitura nëpërmjet shkresës nr.98 prot., datë 2.4.2021 dhe në vijim, të shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës, për dhënien e miratimit paraprak për rritjen e pjesëmarrjes influencuese të ortakut ekzistues MOSCOPOLE INC, SHBA nga 30 % në 80 % në kapitalin e shoqërisë “Tranzit” sh.p.k., subjekt financiar jobankë, i licencuar nga Banka e Shqipërisë me licencë nr. 20, datë 04.08.2010.

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 9662 datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (kontrollit) në masën 80% të ortakut ekzistues MOSCOPOLE INC, SHBA në kapitalin e subjektit financiar jobankë “Tranzit” sh.p.k.

DREJTOR

